

ADEM ZAPLLUZHA

**NUK MJAFTON TË
KESH VETËM EMËR**

Redaktor:
Kujtim Hajdari

Recensent:
Kujtim Hajdari

Lektor:
Veli Veliu

Piktura në ballinë :

Besim Lutolli - Beci

NUK MJAFTON TË KESH VETËM EMËR

ADEM ZAPLLUZHA

**NUK MJAFTON TË
KESH VETËM EMËR**

**Shtëpia botuese
TRENDI
Prishtinë 2020**

Rreth vëllimit

“Nuk mjafton të kesh vetëm emër Të poetit Adem Zaplluzha

Një vëllim me tematikë të gjerë dhe aktuale

Kam nderin të prezantoj një vëllim tjetër të poetit të madh të kombit, zotit ADEM ZAPLLUZHËS.

Ai vjen me këtë vëllim pas një numri të madh librash me poezi dhe e rëndësishme është për t’u theksuar jo numri i madh i librave, që sigurisht duhet marrë patjetër në konsideratë , por me tepër dhe shumë me vlerë është për t’u vënë në dukje, përvoja e tij e madhe në fushën e poezisë që e ka bërë të na jap vepra të një niveli të lartë si nga ana artistike ashtu edhe nga ana poetike dhe ideore duke rrahur tema të shumta dhe të mprehta sociale të jetës reale duke e bërë poezinë një rreze dielli që ndriçon këto skuta të errëta e të trazuara të kohës e të jetës me

shqetësimin dhe interesimin për një jetë më të mirë .

Është një poet që është lënë në heshtje ose është folur shumë pak për të nga kritika dhe shtypi i kohës. Do të ishte në interes të kombit, të letërsisë e artit shpalosja veprës së tij dhe dhënia e vendit të merituar të vlerave të tij poetike, të këtij poeti të rëndësishëm me një potencial të konsiderueshëm në këtë fushë të artit, të këtij poeti që edhe në këtë vëllim të fundit pena dhe zemra e tij i shohim të rrahin në çdo varg për Atdheun, për problemet që brejnë shoqërinë tonë të ditëve që jetojmë dhe me merakun dhe kujdesin e tij dhe gjithashtu me thirrjen që herë ,herë bën direkt me vargjet e tij për një ndryshim, për një përmirësim të jetës, për ta bërë atë më të bukur e më të këndshme për ta jetuar.

Unë po ndalem më shumë në tematikat e trajtuara në këtë vëllim, tematika të cilat e bëjnë poezinë një mjet të fuqishëm militant në jetën tonë të përditshme.

Që në poezinë e parë “Rroftë demokracia” autorin e bren shqetësimi për demokracinë që akoma sot e kësaj dite është një ëndërr, akoma vendi lëngon në amullinë politike të krijuar dhe kjo për fatin e keq se këtë demokraci e dëmtoi shumë mishmashi që u krijua në udhëheqje me futjen e zgjedhjen e njerëzve të papërshtatshëm apo të interesuar për ta penguar demokracinë

“Ah kjo demokraci e pavlerë
Me këtë lesh të palarë
Nuk mund të thurët trikoja
Zorrët e mi trokasin në portat e urisë
Kurse në anën tjetër
Dëgjohet zëri i turmës rroftë demokracia”

Po kështu na jep bukur paqartësinë politike të masave, paqartësi kjo e krijuar nga parti e grupe të shumta politike që të gjithë premtojnë se do të bëjnë diçka për kombin por në fakt asgjë nuk bëjnë veç vjedhjes dhe çoroditjes politike sa që dhe masat humbin

ndërgjegjen e tyre dhe kthehen, siç thotë
poeti në turma e nuk dinë nga të mbajnë, kë
të mbështesin

“Nuk i ndalë britmat e egra
Dhe të pakontrolluara të masës
Rroftë demokracia në pelena
Poshtë demokracia e tredhur
Jehon zëri i vdekur i turmës trotuareve”

Gjithnjë me shqetësimin e demokracisë që
nuk ecën, poeti psherëtin me dhimbje siç e
shohim në vargjet e poezisë “Kam të ftohtë
nëpër damarë” ku thotë:

“Ah koha ime e re dhe ajo e vjetër
Dyzet vjet e pakëz më shumë
Barta kripë të pajodizuar
Eshtrat po më kërcasin nga barra
Më duket se në kurrizin tim
Ende paska mbetur shija e hidhur e kripës”

Duke na dhënë me zërin e tij proteste se nga ato vuajtje të asaj kohe pak po ndryshojnë gjërat, në kurrizin e tij akoma ka mbetur shija e hidhur e kripës, e jetës së vuajtur e të rëndë të së kaluarës.

Poezitë që rrahin temën e demokracisë në aspekte dhe këndvështrime të ndryshme të saj janë të shumta duke ngritur e trajtuar probleme të rëndësishme, një problem mjaft shqetësues do ta shikojmë në vargjet e më poshtme tek poezia “Lëkurën e qiellit tim:

Ah kjo demokraci e vrarë
Që në lindje
I pranoj në gjirin e saj
Të gjitha llojet e kandrave
Sa që s’mbeti asnjë vend për intelektualët”

Mos vënia e intelektualeve, lënia e tyre mënjanë në fushën politike shpesh dhe në atë ekonomike ishte një nga shkaqet kryesore të degjenerimit të demokracisë.

Dhe në një demokraci të tillë të degjeneruar
heroi lirik në poezitë e tij shpërfigurohet te
“Duart e dërrmuara” do të gjejmë vargjet:

“Nuk di në cilin hon kam mbetur
Ku e kam dorën e djathtë
Dhe këmbën e majtë
Çdo gjë sot
Po më shkon për së mbrapshti”

Një hero lirik që po në këtë gjendje e gjejmë
në realitetin e sotëm shqiptar e jo vetëm kaq
po ka humbur edhe shpresat e nuk po sheh
dot të ardhmen:

“Për së tepërmi jam lodhur
Duart e nakatosura
Lëvizin si gjymtyrët e ndonjë oktopodi
Mbi dallgët e detit të çmendur
Nga ky hon s’paskam se si të dalë”

Nuk arrin të bëj një vizion, të shoh një
horizont për të dalur nga ky hon, të

përfytyroj e të ndërtojë një të ardhme për të qenë.

Ku ta gjej e si ta gjej me pushtetarë të tillë, me këto që po shohim në këtë demokraci të bastarduar:

“Çfarë nuk ngjan në demokraci
Fluturimet e karrigeve
Sharjeve dhe ofendimeve
Janë ushqim i përditshëm
Ky sistem pa asnjë vlerë njerëzore
Troket nëpër errësirë pa fener”

Shprehet poeti në poezinë “Në ingranazhet e padrejtësisë” duke na dhënë një portret të pushtetarëve të sotëm që ikin në errësirë pa fener, pa asnjë ideal, pa asnjë pikësynim.

Temën e kësaj pseudodemokracie do ta shohim në shumë e shumë nga poezitë e tij që trajtojnë aspekte të ndryshme si p.sh. në poezinë “Ja pra se si duket demokracia”, ku na jepet injorimi e poshtërimi që i ka bërë inteligjencës:

“Dje ishte profesor me nam e nishan
Kurse sot argat me kaci
Shpirtin gjallë mezi e mbanë”

Apo në poezinë tjetër “Çfarë të bëj unë i
mjeri” ku na jepet një plagë tjetër , ajo e
korrupsionit të sistemit:

“I shami të shanë
Kurse i pandershmi të çnderon
Askush askujt
S’ka se çfarë t’i bënë
Me dy lekë të mykur sistemin e korrupton”

Kjo demokraci për poetin që si për të gjithë
ne ishte një ëndërr e bukur, ishte diçka që
mezi po e prisnim, tek e cila do të gjenim,
lirinë e personit, lumturinë e jetës:

“Më kujtohet kur qaja si fëmijë
Pasi lexoja shtypin e huaj
Për demokraci
Lexoja duke e mbuluar kokën
Me qullët e djersitur të kuajve”

Thotë tek poezia “Afishet e ngjitura duke na kujtuar se po vinim nga një sistem tepër barbar:

“Ishim nën thundrat
E një sistemi të egër të pashpirt
Nëpër qelitë e të cilit
Ngordhnin edhe kandrat
Ngordhnin hardhucat për çdo ditë”

Dhe herë pas here, në retrospektivë na jep skena makabre të atij sistemi si tek poezia “Ishte koha e nxjerrjes së arkivoleve”:

“Rrallë herë ngjante
Të hamë dy herë bukë
Me mikun e qelisë në një tryezë
Të nesërmen
Shikonim arkivolin e gozhduar
Duke bartur mbi një karrocë të zezë”

Tema e regjimit të dikurshëm komunist do të zërë vend edhe kjo në shumë poezi :

“Nuk ka lagje apo rrugë
Që nuk e mban emrin e ndonjë luftëtari
I cili gjunjëzoi komunizmin
Ra si Troja
Kafsha e egër e njerëzimit

Ra komunizmi për të mos u ngritur kurrë
më”

Do të shprehet në poezinë “Kafsha e egër e
njerëzimit”

Një temë tjetër e rëndësishme dhe realizuar
bukur është ajo e sakrifikimit për Atdhe që
do ta gjejmë në poezinë prej së cilës merre
edhe titullin vëllimi “Nuk mjafton të kesh
vetëm emër”:

“Për së tepërmi më pëlqejnë
Zërat që sillen përreth
Këmbëve të ushtarëve të panjohur
Sepse të vdesësh për atdhe
Nuk mjafton të kesh vetëm emër”
Gjithë kush mund të sakrifikojë për Atdhe,
mjafton, siç thotë poeti po në këtë poezi, të

jesh rigë e kuqe shiu, të kesh zemër te madhe e ideale të larta.

Tematika është shumë e gjerë në poezinë e tij; do të gjejmë atë të trashëgimit të virtyteve e të atdhedashurisë nga prindërit si tek poezia “Sa bukur qante ai burrë gjigant”

Temën e njerëzve të respektuar që gjithë jetën e tyre ja kushtojnë me zell e pasion punës si te figura e mësuesit në poezinë “Për udhëtimin e fundit.

Temën e të qenurit njeri që do ta gjejmë në poezinë “Përpos emrit”

Temën e dashurisë së Atdheut si tek poezia “Unë nuk kisha tjetër Atdhe”

E tema të tjera të shumta që natyrisht e me kënaqësi do t’i gjeni në këto poezi të mrekullueshme të këtij vëllimi të shkruar me një gjuhë të kuptueshme e të thjeshtë, me një leksik të pasur e të zgjedhur, ku nuk mungon figuracioni i bukur letrar i përdorur me kujdes e me shije të lartë artistike duke bërë që figurat letrare të ndrijnë si rubin nëpër vargje duke rrezatuar me shumë dritë në to e

duke rritur më shumë shijen e bukurinë poetike të vargjeve.

Vëllimi është shkruar në vargje të lira që ruajnë bukur dhe përherë ritmin e brendshëm poetik pa kaluar as njëherë në prozaizëm dhe pa e rënduar mënyrën e bukur të shprehjes së mendimeve të autorit. Poezitë janë përgjithësisht të ndara në strofa me numër të ndryshëm vargjesh dhe vargjet janë me metrikë të ndryshëm.

Rimën e ndeshim pak në poezitë e këtij vëllimi, janë vargje të bardha, pa rimë, por kjo nuk ua zbeh aspak bukurinë poetike, mjeshtëria me të cilën i thur vargjet, ritmi i brendshëm që godet bukur përherë, leksiku i pasur dhe i zgjedhur që përdor i bën që vargjet të rrjedhin si një ujëvarë e të joshin me ëmbëlsinë e tyre.

Duke ju uruar lexim të mbarë i urojmë autorit suksese të mëtejshme në vepra të reja.

Cikli i parë
Sa bukur qante ai burrë gjigant

RROFTË DEMOKRACIA

Ah kjo demokraci e pavlerë
Me këtë lesh të palarë
Nuk mund të thurët trikoja
Zorrët trokasin në portat e urisë
Kurse në anën tjetër
Dëgjohet zëri i turmës rroftë demokracia

Një zë i lashtë si nga dheu
Hungëron e del në shesh
Me vigma të trishtuara bërtet
Kush e solli demokracinë
Si lakuriqët e qullur të natës
Rropullitë protestojnë bulevardeve

Një shi skajshmërisht i trullosur
Me ironi i shikon trotuaret e lagshta
Teneqja e vjetër në gardhin e kujtesës
Nuk i ndalë britmat e egra
Dhe të pakontrolluara të masës
Rroftë demokracia në pelena
Poshtë demokracia e tredhur
Jehon zëri i vdekur i turmës trotuareve

KAM TË FTOHTË NËPËR DAMARË

Ky acar nofullthyes me tërë trishtim
Po i thyen gurtë në pragjet e lagjeve
Nëpër oxhaqet e të varfërve përdridhet
Një tym i zi katran
Më duket se kanë vdekur perënditë
Këtu vetëm këndesat e metaltë këndojnë

Kam të ftohtë nëpër damarë
Dimri i zi s'mund të qarkulloj
Gjaku i ngrirë i gërryen muret e zorrëve
Kjo epilepsi e demokracisë
M'i ka ngulitur në parzëm thonjtë
E papastra epileptike

Ah koha ime e re dhe ajo e vjetër
Dyzet vjet e pakëz më shumë
Barta kripë të pajodizuar
Eshtrat po më kërcasin nga barra
Më duket se në kurrizin tim
Ende paska mbetur shija e hidhur e kripës

Si pampurat e deteve të çmendur
Gjëmojnë molet e baltosur
Shija kryengritëse e kripës
Një kohë të gjatë
Mbase ka filluar të çeli mjegull
Aso lloje mjegullash
Që prodhojnë forma të hidhura dhembjesh

NOTONIN ULLINJTË E KALBUR

Nga kundërmimi i plagëve
Dhe i dhembjeve
Sipër dallgëve të mykura
Qenkan kalbur pragjet e traversave

Nëpër mole të harruar kahe
Peshqit e ngordhur protestojnë
Tasat e mykur të konservave
Nuk i ndalin britmat të moli

Dimri dhe acari i padurueshëm
Duken si binjakët Sijamez
Brigjeve të dehur
Notojnë ullinjtë e kalbur
Nga rrënjët pikon
Një eliksir i trishtuar infektues

Nëpër skutat e moleve të lashtë
Dhe kafeneve të braktisura
Marinarët gjysmë të gjallë
Me shumë vështirësi
Qëndrojnë në këmbët e tyre prej kripe

LËKURËN E QIELLIT TIM

Sikur të kishim ditur
Se saq lakuriqe qenka demokracia
Me gishtat e mi të thyer
Kurrë nuk ja kisha grithur
Lëkurën e gristë të qiellit

Ah kjo demokraci e vvarë
Që në lindje
I pranoj në gjirin e saj
Të gjitha llojet e kandrave
Sa që s'mbeti asnjë vend
Për intelektualët e mirëfilltë

Më thoshte miku im kryengritës
Ai luftëtar i vjetër i lirisë
Se edhe demokracia e ka shijen e pelinit
Është një pemë tejet e hidhur
Sa që ta turbullon mendjen

Unë si gjithmonë kokëfortë
Asnjë fjalë se morra seriozisht
I theva dhëmbët dhe dhëmballët
Duke u gërvallur bulevardeve
Me turmën prej mishi të kalbur
Rroftë demokracia poshtë demokracia

KY DET I ÇMENDUR

Nëpër një acar të paparë
Plim pulëbardhash
Fluturojnë mbi molin e vdekur
Anijet e përmytura
Po i përpinë varkat e fundosura

Gjallesat mbi këto dallgë
As nuk vdesin
E as s'jetojnë
Pranë brigjeve uji i zi
Kundërmon naftalinë

Pulëbardhat e plagosura
Si për inat
Nuk i ndalin krakëllimat
Krakëllijnë edhe valët e helmuara
Ky det i çmendur si hajdutët tinëzarë
Po fundoset në shpirtin e njeriut

DUART E DËRMUARA

Nuk di në cilin hon kam mbetur
Ku e kam dorën e djathtë
Dhe këmbën e majtë
Çdo gjë sot
Po më shkon për së mbrapshti

Nga sytë e lëbyrtë të demokracisë
S'rigon asnjë pikë loti
Secili tregim
Mbi dërrasat e teatrit antik
Ka nga disa misterë të panjohur

Për së tepërmi jam lodhur
Duart e nakatosura
Lëvizin si gjymtyrët e ndonjë oktopodi
Mbi dallgët e detit të çmendur
Nga ky hon s'paskam se si të dalë sonte

RËRA NËN HIJEN E MYKUR

Këtë etje s'mund ta shuaj me asnjë etje
Ky kaktus i egër
Paska mbetur pa asnjë gjemb
Rëra nën hijen e mykur të thatësisë
Përjeton katarzën e nëntë të ferrit

Një hardhucë e verdhë fluturues
Shikon përtej vetvetes
I shikon urat e thyera të dynjasë
Shikon se si dielli i shurdhtë
I ka hapur sytë dhe gojën e pangopur

Sonte kam shumë nevojë
Kam nevojë si zhapiku të ndjej
Shijen e etjes së një imagjinatë
Kjo kripë e kaltër
Paska humbur ngjyrën e syve të detit

Nuk shoh më asnjë njeri këndeje pari
Vetëm hardhucat dhe kaktuset
Bisedojnë me ajrin e tendosur
Dhe me zabullimën e mbrëmjes
Bisedojnë për farën e së nesërmes
Prishtinë, 14 janar 2019

BREKËÇJERRËT BREDHIN SOKAKËVE

Ah ky det i çmendur i varfërisë
Dhe kjo demokraci
Na lënë pa asnjë ëndërr
Në fillim ishte premtimi
Kurse në fund
Si nga nëntoka mbiu zhgënjimi

Nëpër rrugë britma njerëzish
Vigmat e egra të turmave thërrasin
E këlthasin
Rroftë demokracia lakuriqe
Poshtë komunizmi i veshur me gënjeshtër
Shtypjani kokën gjarprit të kuq

Kurse pas njerëzve dhe turmës së zezë
Mbesin mbeturinat e të gjitha llojeve
Këmisha të grisura
Brekëçjerrët bredhin sokakëve
Të brendshmet e njerëzve
Kundërmojnë hashash të mykur

PËRTYPNIN ATË UDHË TË TURPIT

Thonë se shpresa vdes e fundit
Por unë vdiqa
Para se t'i hapi sytë
Në lagjen tonë
Nga katër persona i varrosnin në një varr

Dielli kishte ikur diku në maja
Këmbët strukur nën rrënjë
Preknin fundin e tokës
Ose të një tregimi të imagjinuar
Që prite vdekjen e bardhë

Tani kuptova se në demokraci
Njerëzit vdesin si kuajt
Vdesin duke ecur xhadesë
Me një kokë të prerë
Për të mbërrirë në kamaren e turpit

Nga mëgojëzat e ndryshkura
Derdhej një shkumë si dëbora
Përtyreshin kuajt
Përtypnin atë udhë të gjatë të turpit
Për të mbërrirë në kryeqytetin e kokave

NË INGRANAZHET E PADREJTËSISË

Çfarë nuk ngjan në demokraci
Fluturimet e karrigeve
Sharjeve dhe ofendimeve
Janë ushqim i përditshëm
Ky sistem pa asnjë vlerë njerëzore
Troket nëpër errësirë pa fener

Më kujtohet sistemi i vjetër
Ai i djajve të kuq
Sa ora të burgoste
I cili ta zhveshë lëkurën
Dhe ta veshë për mrekulli
Këmishën e të çmendurit

Kur ndalem e meditoj
Për sistemet e njerëzimit
Secili më i zi se tjetri
Nuk mund të gjeje dot asnjë derman
Nën ingranazhet e padrejtësisë
Ta bënë jetën vajë e piskamë

KËSHTU QË SECILI PREJ NESH

Nuk njoh asnjë njeri këtu
Në Kosovë
Që nuk mund të tregoj
Nga një tregim fantazmagorik

Gati secili prej nesh
Nëpër birucat e burgjeve
Takohej me nga një mi
Ose kandër njëqind këmbësh

Ndoshta ishim me fat
Në fatkeqësinë tonë
Tek e fundit nuk mund të vritej
Liria e një popull të tërë

Kështu që secili prej nesh
Kemi nga një tregim
Ose anekdotë për gardianin
Që gogësishte një erë të keqe naftaline
Prishtinë, 14 janar 2019

JA PRA SE SI DUKET KJO DEMOKRACI

Rroftë liria poshtë demokracia
Mos ja ndjefsha zërin
Eh moj e mjera demokraci
Në çfarë ujëra të pista noton

Ne ëndërronim një tjetër sistem
Të jemi të gjithë të barabartë
Para gjyqit e policit e Zotit
Por ja që na doli dardha me bisht

Nëse duhet për nesër
Do e këpus njërin gisht
Bariu u bë mjek
Kurse mjeku politikan karabisht

A thua vallë
Kësaj duhet t'i themi demokraci
Dyzet vjet punova në minierë
Sot varfëria sytë po m'i nxjerr

Ja pra se si duket kjo demokraci
Dje ishte profesor me nam e nishan
Kurse sot argat me kaci
Shpirtin gjallë mezi e mbanë

NË ÇDO KOHË NA E NGRINË GJAKUN NË SHPIRT

Në baltë paska mbetur demokracia e brishtë
Herë si shiu i pranverës
E herë si breshëri i verës
Në çdo kohë
Na e ngrinë gjakun në shpirt

Ne mbase nuk ditëm të ëndërrojmë
Ëndërruam krejtësisht
Një tjetër stinë
Kurse në anën tjetër të gjumit
Na doli dimri me dhëmbë prej hejeve

Ishim dikur më afër perëndimit
Se sa lindjes
Kurse sot kanë ndryshuar kahet
Nuk dimë më kah i bie lindja
E kah perëndimi i egër

Populli thotë se kemi mbetur
Si qurra në mjegull
Në cilin do anë t'i drejtojmë shpresat
E kah zhgënjimet
Kjo kohë e turbullt na i morri mentë

ÇFARË TË BËJ UNË I MJERI

I shami të shanë
Kurse i pandershmi të çnderon
Askush askujt
S'ka se çfarë t'i bënë
Me dy lekë të mykur sistemin e korrupton

Haj demokraci haj ta pamë sherrin
Ne ëndërruam kopshtin me lule
E këndeja na dole
Një mal i keq me gjemba
Na dole si mos më zi

Hajde moj hajde demokraci
Hidhe vallen
Mes këtij trishtimi
Çfarë të bëj unë i mjeri
Më humbi sevdaja më iku gëzimi

DIKUSH I BIE THUMBIT

Dola në kopsht mes portokajve
Njëri qante me lot krokodili
Kurse tjetri si për mahi
Këndonte mbi degë
Ashtu siç këndon vetëm trishtili

Zëri dëgjohej diku larg
Në shtatë mëhallë këndonte gjeli
Njerëzit kalonin varg–varg
Nëpër një vigë
Ku s'qëndron as harabeli

Kështu e ka jeta
Në mjedis të tepsisë
Si lakrori i papjekur që s'kapërdihet dot
Në shesh del lakuriqe e vërteta
Ja kështu duket kjo demokraci sot

Dikush i bie thumbit
E tjetri patkoit
Njëri i uritur rropullitë i këndojnë
Tjetri hanë petulla me mjaltë
Diku shpërndahen uratat e diku mallkojnë

NE TË MJERËT KËRKONIM MË MIRË

Kurrë nuk kuptova
Se çfarë njerëzish jemi
Nëpër mure
Shkruanim demokraci
Me dy gishta drejtuar qiellit
I grisnim mjegullat si për mahi

Dikur vonë shkarkuam nga shpina
Të zitë e ullirit
Dhe trastën e të keqit
Duke u galduar nga këto pamje magjike
U gëzua edhe dreqi i birit të dreqit
Pohuam se jeta qenka fantastike

Ja që kjo punë për fat të keq
Na doli shejtan
Si lubia me brirë
Në secilin hap na e thyente ashtin
Thërrisnim rrugëve anë e mbanë
Të mjerët e Hygos pa nam e nishan

AFISHET E NGJITURA

Më duket se doja të derdhi
Pakës lot mbi katastrofën e sistemit
Por ja që
Nga sytë e gurtë të shkëmbit
S'mund të derdhej lëngu i trishtimit

Më kujtohet kur qaja si fëmijë
Pasi lexoja shtypin e huaj
Për demokraci
Lexoja duke e mbuluar kokën
Me qullët e djersitur të kuajve

Ishim nën thundrat
E një sistemi të pashpirt
Nëpër qelitë e të cilit
Ngordhnin edhe kandrat
Ngordhnin hardhucat për çdo ditë

Shikonim diellin e demokracisë
Qanim me dy gishtat e ngritura rrugëve
Kurse afishet e ngjitura
Nëpër muret e qytetit
U ngjanin trëndafilave të kuqe

ISHTE KOHA E NXJERRJES SË ARKIVOLEVE

As që guxoj të flas haptazi
Të ju them një sekret
Asnjëherë nuk arrita
T'i shoh miqtë e mi dy herë
Para një agimi të përgjakur
I zhdukun si hijet e zeza

Rrallë herë ngjante
Të hamë dy herë bukë
Me mikun e qelisë në një tryezë
Të nesërmen
Shikonim arkivolin e gozhduar
Duke bartur mbi një karrocë të zezë

Përmalloheshim por nuk guxonim
Të kundërshtojmë
Largimin e hijeve të murrme
Sa herë që hapeshin portat e hekurta
Ishte koha
E nxjerrjes së arkivoleve

U PRININ DERI NË VDEKJE

Ja se përse mbusheshin
Sheshet rrugët dhe bulevardet
Demokracia na dukej si një pikë ujë
Në shkretëtirën e pasosur
Na dukej vetja
Se deveja e plagosur

Vigmat kurrë nuk i ndalëm
Pas nesh si furi
Dilnin edhe baballarët
Nënat gatuanin petulla me lot
Demonstruesit domosdo
Kishin nevojë për një krodhe bukë dot

Nëpër rrugët e boshatisura
Mund të takonim
Vetëm qentë e zgërlaqur
Ata burra të sojit
U prinin turmave të demonstruesve
U prinin deri në vdekje

I VRAMË EDHE ZOGJTË

Më në fund
Si një ortek bore në pranverë
Rra komunizmi
Në dy gjunjë rra e keqja e dynjasë
Dhe ia behu demokracia
Me paterica të kalbura

Kudo u shembën përmendoret
Nuk mbeti asgjë në këmbë
Nga dora që kishin ndërtuar të kuqët
I vramë edhe zogjtë
Që kishin fluturuar
Mbi çatitë e komunistëve

Ishte një eufori e padëgjuar
Fanfarat zhurmonin
Në të katër anët e qytetit
Nëpër rrugë
Këndohej në disa gjuhë Marsejeza
Këndohej si himni i jonë pa tekst

TË MBJELLIM FILIZA TË REJA

Nuk di për sa kohë
Duhet të qaj për të kaluarën
T'i ngre në këmbë të vdekurit
Që vdiqën për demokraci
T'i ngre edhe të gjallët e vdekur

Atdheu nuk i duron poltronët
Kemi nevojë
Kemi shumë nevojë t'i ringjallim kopshtet
Të mbjellim filiza të reja
E nesërmja nuk e duron përtacinë

Është koha të ecim ledheve
Të ecim siç ka ecur e tërë dynjaja
Demokracia ka edhe anët e këqija
Por ne domosdo
Duhet t'i përzgjedhim ato më të mira

Shikoni se si kjo ditë e stërlodhur
E ka buzëqeshjen e saj
Qeshin edhe gjethet nëpër degët e thyera
Qeshë bari i shkelur me shekuj
Gëzohet i tëri një popull i prangosur

MBASE ISHIM BIJTË E QIELLIT

Ky diell i sivjetshëm me ferra
As i ngrohtë si duhet
E as i acartë
Disi ka mbetur pa itinerar
Mbi kreshtat e pakalueshme të këndesave

Kemi patuar edhe ditë
Më të këqija
Kur hëna dukej si një pjatë e thyer
Prej porcelani
Dukej e sëmurë deri në vdekje

Ne gjithmonë ja mbështillnim
Kokën me një shami dyngjyrëshe
Më këmishën tonë të grisur
Ja fshinim lotët
Mbase ishim bijtë e qielli

Kaluan me qindra vite
Në heshtje duke pritur
Buzëqeshjen alegorike
Dhe ja më në fund buzëqeshi hëna
Buzëqeshi si një vashëz e rilindur

KAFSHA E EGËR E NJERËZIMIT

U përmbysë komunizmi
Si ngordhësirë e zgërlaqur
Rra në dy gjunjë
Rra si Troja
Kjo sëmundje e madhe
Rra për të mos u ngritur kurrë më

Nëpër bulevarde dhe sheshe
Po mbinë përmendore të reja
Prej ashti dhe mishi
Po mbinë heronjtë
Që sakrifikuan jetën
Për atdheun tonë të robëruar

Nuk ka lagje apo rrugë
Që nuk e mban emrin e ndonjë luftëtari
I cili gjunjëzoi komunizmin
Rra si Troja
Kafsha e egër e njerëzimit
Rra komunizmi për të mos u ngritur kurrë më
Prishtinë, 15 janar 2019

Cikli i dytë
Sa bukur qante ai burrë gjigant

ISHTE NJË NJERI I THINJUR

Nuk di sa kohë jetova
Në zhgënjim
Por kurrë s'kuptova
Kush ishte Zoti im

Në shtëpi si një perëndi gjigant
Më dukej babai
Nëna po ashtu qëndronte në pedestal
Zoti im ishte ati i etërve të mi

Sa herë që dilja në qytet
Zot ishte polici kokëtrashë
Me një kamxhik
Prej bishtit të kalit e rrihte tokën

Fqinji të cilin e quanim babëlok
Nga thinjat e tij
Me tërë dimrin e zi
Pikonte shtreza e bardhë

Andaj asnjëherë s'kuptova
Se si dukej Zoti im
Ishte një njeri i thinjur
Ose adoleshent pa i mëshua brisk fytyrës

SA BUKUR QANTE AI BURRË GJIGANT

Thonë se ai njeri
Kishte harruar varrin e vet
kishte harruar të gjitha vuajtjet
Mbase nuk kishte kohë
T'i radhite në rruzare çastet e pikëllimit

Një ditë dielli i dukej si një patate e skuqur
Kurse ditën tjetër
Shkulte hejet e kristalta
Shkulte edhe kujtimet
Nga të cilit si fëmijë ishte ndarë tërë pezëm

Më kujtohet kur im at ndjesë pastë
Mbante në dorë një kryq prej druri
Me një guri të murrmë
Më duket se i ishin dy kryqe
Një për këtë botë kurse tjetrin për amshim

Gjithmonë shikonte i trazuar
Qiellin e ngrysur të atdheut
Shikonte dhe i fshinte lotët e drurëve
Sa bukur qante ai burrë gjigant
Kur përmallohej për vatrën e uzurpuar

FURTUNA FRYNTE SI E ÇMENDUR

Ishim shumë të lodhur
Nuk ndjenim acarin
Gishtat e këmbëve
Kishin marrë ngjyrën e thëngjillit

Me një automatik të vjetër
Shikonim përtej lumit
Rrënjët e lisave
Ishin në gjendje më të keqe se këmbët

Për çudi në këtë dimër të acartë
Binte shiu i zi
Një e reshur e metaltë
Trokite në kokat tona të qullura

Në llagëmin e tretë
Një çun sy shqiponjë
I hukate thonjtë e ngrirë
Mbase nuk i ndjente më gishtat e hollë

Furtuna frynte si e çmendur
Nëpër xhepat tona të grisura
Nga të cilit
Na kishin humbur plumbat e fundit

SHIKONTE NË MËNYRË HABITORE

Ishte një mur i lartë
Mbi telin e ndryshkur
Me gjemba të çeliktë
Qielli lakuriq luante tangon e fundit
Luante lojën plumbave
Mes shtatë zjarreve të ndezura

Kalaja si një kështjellë përrallash
Shikonte në mënyrë habitore
Dallgët e trullosura
Të Lumëbardhit
Më duket se
Edhe ajo luante lojën e shiut

I gjithë qyteti i shikonte
Këto pamje
Në ballin e hënës surrealistë
Shikonte se si rritej pezmi
I një populli
Rritej si një uragan i lënduar

NUK MJAFTON TË KESH VETËM EMËR

Për t'i rezistuar vetëtimave
Duhet të jesh rigë e vockël shiu
Ose thimthi i bletës adoleshent
Përndryshe
Do mbetesh përmendore e humbur

Mua më pëlqejnë varret
E ushtarëve të panjohur
Për së tepërmi më entuziazmojnë
Heroizmat e rigave të shiut
Kur i vërsulen vetëtimave si kuçedrat

Atë çast mjegullat luajnë pas perdeve
Lojën më të trishtuar
Të amshimit
Luajnë me mortin si me hijet
E vdekura në horizontin gjysmë të gjallë

Për së tepërmi më pëlqejnë
Zërat që sillen përreth
Këmbëve të ushtarëve të panjohur
Sepse të vdesësh për atdhe
Nuk mjafton të kesh vetëm emër

TAKOVA HIJEN TIME

Në këto çaste sublime
Nuk kam asnjë ide për pasqyrat
Më duhet një tjetër dimension
T'i shoh njerëzit jo si krijesa tokësore
Por si ato jashtëtokësore

Sepse tokësoret janë vdekatarë
Me qindra mëkate
Që nuk u përkasin njerëzve
Kurse jashtëtokësorët
Më duken si krijesa hyjnore

Këto ide që më paraqiten
Orë e çast
Mbase shkunden nga shpirtrat
E yjeve endacakë
Shkunden për të na mbrojtur nga djajtë

Sonte kur isha duke kërkuar
Yllin tim klandestin
Takova vetveten diku në mes të udhës
Takova hijen time
Duke u thyer në shtatëqind riga shiu

KUR KËNDON NËPËR ULLUKËT E ÇATIVE

Nuk di për të kënduar
S'mjafton të kesh vetëm zë
Përpos zërit
Të duhet diçka më shumë se imagjinata
Që pushton shpirtin pasi që lëshohet
Agullima e parë në qenien e vesës

Miqtë më thonë se kam zë
Kurse unë ua kthej
Duke qeshur e zgërdheshur
Përplot ironi
Zë kanë edhe drurët
Por kurrë nuk këndojnë

Po ju them
Për së dyti ose për të shtatën herë
Se për një këngë të mirëfilltë
Duhet diçka
Më shumë se dashuria
Më shumë se zëri i shiut kur bie në pranverë
Dhe këndon nëpër ullukët e çative

NËPËR RRËNJËT E ZAMBAKËVE

Sonte gjërat paskan ndryshuar
Për së mbrapshti
Kanë vdekur drurët
Nga etja e madhe
Nëpër rrugët e boshatisura
Ngordhin hardhucat

Megjithatë qyteti merr frymë
Gjëja e parë që më bie në sy
Janë teatrot
Që s'i kanë lëshuar perdet
Britmat Hamletjane
Kudo dëgjohen nëpër mëhallë

Më duket se ky është fundi
I një tjetër tragjedi
Të pa fund
Nëpër rrënjët e zambakëve
Paskan ngordhur molat
Lumëbardhi i gërryen brigjet e veta

ME SHIJEN E NJELMËSISË

Nëpër kantiere ku shkarkoheshin
Anijet e ngarkuara me kripë
S'kishim
Asnjë kokërr të bardhë
Ta ngjyejmë kafshatën e thatë

Kurse në anën tjetër
Shkelnin kripën që derdhej
Nga thasët e grisura
Prej lagështisë
Së ujit të njelmët të syrit

I shkarkonim thasët
Me kripë e sheqer
Por nuk mund ta ngjyenim kafshatën
As në tokën e mbuluar
Me shijen e njelmësisë

Prishtinë, 16 janar 2019

MBASE PIKONTE GJAKU I GJELAVE

Dy gjela të kuq mbase edhe të zinj
Në kopshtin e ullinjve
Çukitnin njëri-tjetrin
Te rrënjët e kalbura të rrapeve
Çukitnin stinën e vonuar

Nuk ishte dimër por ama
As vjeshta s'kishte mbërritur
Stinët disi e kishin humbur itinerarin
Mbase përjetuan thellë
Disfatën e pemëve të krasitura

Kjo kohë asnjëse
As pulë as gjel
Siç thotë populli as asht as mish
Davaritej mes mjegullave të plumbta
Davaritej në disa drejtime

Ne mbetëm pa asnjë shpresë
Nga gishtat tona të ngrira
Pikonte një lloj thëngjilli
Pikonte një lëng i mpirë nga ngrica
Mbase pikonte gjaku i gjelave

KISHIN IKUR EDHE ÇAFKAT

Kohë e shthurur mes mjegullave
Mbi oxhak
Një gjel prej teneqeje
Herë shikonte lindjen
E herë perëndimin e ngrysur

Në lagje s'kishte mbetur
Asnjë daullexhinj
Evgjitët e fundit që banonin këtu
I patën lyer muret e shtëpive
Me një bojë të zezë nga dheu dhe ikën

Ikën diku larg prej vetvetes
Thua se asnjëherë
Nuk kanë qenë banorë të këtij qyteti
Kishin ikur edhe çafkat
Vetëm na shqetësonin pëllumbat e egër

Na shqetësonin pa masë
Edhe krakëllimat e korbave
Nuk kishte mbetur asnjë njeri
Tok me daullexhinjtë
Që na lajmëronin ardhjen e ndonjë ushtrie
Ikën edhe zogjtë e fundit nga plepat

KUR JEMI NË NDONJË GJENDJE ASNJANËSE

Këtu gjithmonë befasisht
Ndryshon koha
Bie një mbrëmje
Dhe të nesërmen zgjohet
Si e rilindur nga katastrofa e saj

Edhe njerëzit si gjërat
Ndryshojnë
Në të mirë të kohës
Kur vijnë këtu shirat
Vakt e pa vakt ndryshojnë stinët

Nëse ngjan ndonjë katastrofë
Natyrore
Ne ia vëmë shpinën të keqes
Dhe sa ora
I stabilizojmë rrënjët e lënduara

Nuk më kujtohet asnjëherë
Që jemi ankuar
Ankesat i kemi inat
Kur gjendem në ndonjë gjendje asnjëanëse
I themi vetes duke qeshur sa jemi mirë

DIKUSH I ÇRRËNJOSI EDHE KISHAT

Jo që u larguan kanjushat
Por asnjë gjeth
Nuk paska mbetur
Nëpër drurët e kopshtit

Më duket se dikush i shkuli
Edhe njerëzit
Nga këto fusha mëllenjash
I shkuli oxhaqet që tymosnin me krenari

Nga ky qytet fantazmë
Qenkan shpërngulur edhe qentë
Kujt i mbeti kjo mëhallë ëndrrash
Qetësia e llahtarshme dëgjohet skutave

Nuk kalojnë as buburrecat
Nëpër pikëllimet e kopshteve
Dikush i çrrënjosi kishat
Për t'i ngritur faltoret e veta

PËR UDHËTIMIN E FUNDIT

(Kushtuar mësuesit të panjohur)

Ai kalonte andej trotuarit
Kalonte
Me gjymtyrë të lodhur
Nga dora e djathtë e cila dridhej
Tok me shkronjat e alfabetit
Pikonte e kaluara e tij e hidhur

Mundohej t'i lëvizte më tutje
Duart i ngjanin
Gjymtyrëve të oktopodit
Nën pallton e vjetër
Më duket se
I dridhej edhe dora e majtë

Ishte një person i respektuar
Dyzetë vite
S'kishte lëshuar ditarin nga dora
Kishte një ecje grandioze
Më duket se
Ecte si kalaja e vjetër

Ecte trotuareve ai burrë
Me flokë të thinjur
E kaçurrelat të çeliksa
Kalonte çdo ditë
Pranë teatrit të preferuar
Mbase e prite me dëshpërim
Të lëshohen perdet
Për udhëtimin e tij të fundit

NËN STREHËT E HARRUARA

Disa pemë me rrënjë të dyshimtë
Dhe dy kuaj prej mermeri
Qëndrojnë në ballë të sheshit
Pranë brigjeve të gërryera
Të Lumëbardhit
Si nëpër dhomat e spitalit flenë
zogjtë e egër

Shiu pandërprerë troketë te portat
E një këndesi të metaltë
Mjegullat si pa kokë
Sillen vërdallë
Mbi çatitë e qytetit
Nën strehët e harruara
Askush më s'këndon serenata

Rastësisht mbrëmë kuptova
Se në brendinë time delikate
S'kishte mbetur asnjë tregim
I cili mund ta ndryshonte
Itinerarin e shirave
E shirat e egra
Kurrë s'pushojnë në qytetin tim

DUA TË MË PLOTËSOHEN DËSHIRAT

Sonte kam disa dëshira
Të çuditshme
Dua që të mos ketë asnjë lëmsh mjegulle
Mbi çatinë time
Të galopojnë kuajt prej bronzi

Dua që në vend të një peme
Të lindi një tjetër diell
Nga i cili s'do frikoheshin mjegullat
Dhe të mos bie breshër
Kurrë mbi qytetin tim të lashtë

Dua që të marr frymë si peshku
Ose të fluturojë hapësirave
Si ndonjë lejlek pa pasaportë
Dua të më plotësohen dëshirat
Që në atdheun tim të mos ketë uri

PËRPOS EMRIT

Pata thënë dikur më herët
Dhe sërish po të them
Se nuk mjafton
Të kesh vetëm një emër
Përpos emrit
Së pari duhet të jesh njeri

Në vrapin tënd pas etjes
Të mos jesh kurrë i etur
Mirësia i përket secilës krijesë
Ashtu si ka nevojë për ajrin
Po aq ka nevojë
Për ujin dhe për dashurinë

Të kesh vetëm një emër
Në xhepat e tua të grisura
Domethënë
Të mos kesh asgjë me vlerë
E as vetveten
Që fshihet pas një emri anonim

Të jesh vetvetja
Do të thotë se je gjithçka
Uji ajri dhe dielli që të rrethon
Të jesh njeri
E të ecësh drejt të nesërmes
Pa u ndalur asnjëherë
Në ndonjë stacion të urrejtjes

GARONIN HARDHUCAT E PJEKUR

Njëherë moti kur isha i ri
Pata përjetuar
Të shoh në një pemë të egër
Natën e cila kishte humbur
Mes një kopshti lakuriq

I tërë qyteti shikonte me habi
Se si i vdisnin duart
Dhe nga thonjtë i pikonte dita
E cila nuk ishte në gjendje
T'i rikujtoj ëndrrat e saja më sublime

Unë nuk u besoja syve të mi
As vetvetes
Nëpër kopshtin e djegur
Garonin hardhucat e pjekur
Garonin pas bretkosave të panjohura

Që nga ajo kohë e dyshimtë
Kurrë më nuk desha t'i besoj askujt
Ani që më pëlqenin pa masë
Mishrat e pjekura
Por shija e etjes ishte e papërballueshme
Prishtinë, 17 janar 2019

UNË NUK KISHA TJETËR ATDHE

Kjo kartolinë e verdhë
Nuk është e para që po të shkruaj
Me qindra të tilla
Bashkë me zarfet e kaltra
T'i dërgova kur isha në vend të huaj

Gjithmonë t'i kam shkruar
Dhe dërguar
Nga ishulli i mendimeve
Me një pëllumb të bardhë
Një tufë zambakësh Prizreni
Që mos ta harrosh shijen e atdheut

Edhe ti kurrë nuk munde me dallua
Letrën prej ëndrrës
Ëndrrat ishin me qindra ngjyra
Kurse letra dhe pëllumbi
Kishin dy ngjyra bardhë e kaltër

Njëra simbolizonte qiellin
E tjetra detin
Përpos qiellit dhe detit
Unë nuk kisha tjetër atdhe
Në gjeografinë e kujtimeve të mia

NGA NJË APO DY GOTA

Kurrë nuk mësoi njerëzimi
Se sa gota të palara
Ndodheshin në tryezën e fundit
Kur tradhtia lëshoi rrënjë
Mbase aty qëndronin dymbëdhjetë gota
Të palara me muaj e vite

S'di askush se sa njerëz ishin
A thua kishte secili person i ftuar
Nga një apo dy gota
Por gjithsesi
Ishin disa dhjetëra gotash
Mbi tryezën e tradhtisë të asaj dite

Qielli dukej si një hon i pafund
S'dëgjohej zëri i Atit
Ndërgjegjja e gurëzuar
Fshihej pas vetvetes
Mbase nga pamja e parë dukej
Një fshehje misterioze e gotave të palara

MBETI PA FRYMËMARRJE

Pamë shumë njerëz të vrarë lëndinave
Kuaj me grykë të prerë
Atdheu ishte
Një hartë e grisur e historisë
Ishte trishtimi
I dhembjeve të pashëruara

Ju thashë se atdheu ishte një flutur
Krah djegur
Ne në fshat vraponim pas xixëllonjave
Na u deshtë ta ndriçojmë
Errësirën e pafundme
Ku vdekjet dukeshin si fantazmat

Ju ndoshta nuk mund të paramendoni
Por në atdheun tim
Buka i ngjante legjendës së kripës
Kjo tokë e vrarë nga shrapnelat
Mbeti me njerëz që vuanin nga astma
Mbeti pa frymëmarrje gati një shekull

NË HESHTJE PO ZBRAZEJ FSHATI I VDEKUR

Ia kishte kthyer shpinën
Portave të rënda
Ecte me një trastë të grisur
Nga e cila asnjëherë nuk ikën
Dykrenorët e gdhendur

Më duket se nga pak si njerëzit
Lotonin pragjet
Fshati zbrazej
Çmendurisht zbrazej
Si nga murtaja iknin diku pemët dhe kopshtet

Në fund të plepave të vdekur
Pashë ngordhësira qensh
S'kishte mbetur askush
Për t'i varrosur
Në heshtje zbrazej fshati i lashtë
Kurse ne shikonim
Si shurdhmemec njëri-tjetrin

QË KISHIN MBETUR GJALLË

Unë dyshoja në vetvete
Kurse miku im i dyshonte pasqyrës
E cila rrinte varur
Për një litar të kalbur
Në murin e kujtesës së sëmurë

Shikonim përreth korridorit
A thua vallë
Ishte mu këtu vendi jonë i preferuar
Ku fshiheshim prej të tjerëve
Kur luanim lojën symbyllas

Ky korridor na dukej
Si një imazh tejet i largët
Shikonim duart
Preknim lagështit e mureve
Thërrisnim edhe kujtimet e harruara

Dikur vonë shumë vonë
Gjetëm në kujtesën tonë të ndryshkur
Ato pak çaste të jetës
Që kishin mbetur të gjallë
Gjetëm vetveten mes çatave të shembura

NË KËTË SHITJELLIM TË SHURDHTË

Një portë e vjetër qëndronte përballë
Rrapit i cili nuk ishte në gjendje
T'i numëroj gjethet e rëna
Pranë murishtave të qullura
Një hartë e vjetër
Më shumë se disa shekuj ishte shlyer
Nga urinimi i lakuriqëve
Kundërmonte erë të kalbur thëngjilli

Atdheu im kjo tokë e askujt
Asnjëherë nuk ishte në gjendje
Të më kapi për dore
Më shikonte me trishtim
Dhe frikohej
Se sërisht nuk mund të më ndihmoj
Të eci pa paterica

Kam mbetur peng mes dy kohërave
E kaluara
Ishte e trishtë dhe shurdhmemece
Kurse e ardhmja
Pa formë pa shije dhe ngjyrë
Nuk mund ta gjej vetveten
Në këtë shtjellim të shurdhtë

NDOSHTA NJËQIND VJET

Me gishtat të ngrira
Preksha ashtin tim të kalbur
Preksha xhamat e palara
Te një dhome me një vazo të vjetër
Dhe disa lule të kalbura

Më kujtohet
Fare mirë më kujtohet
Kur ishte dimri këtu
Në fund të korridorit
Mbolla një limon të shartuar
Por kurrë nuk lëshoi asnjë lastar

Shikoj dyshtemenë e vjetër
Dërrasat kishin humbur pamjen
Dukeshin si ashkla të djegura
Mbase molat
Bënin pjesë në aktin e fundit

Një duhmë e rëndë
Shumë e rëndë
Na i prekte shqisat e të nuhaturit
Ndoshta njëqind vjet
Asnjë njeri s'kishte banuar këtu

TË TROKITURAT E RIGAVE TË SHIUT

Kjo dhomë e vogël
Dhe ky shi i pashpirt
Që po rigon
Po rigon mbi kokën time
Mbase kanë vendosur
Përfundimisht të më çmendin

Më kanë thënë se çatia
Nuk është në gjendje të mirë
Por unë prapëseprapë
Vendosa të fle në atdheun tim
Në atë dhomë
Ku për herë të parë qava dhe dashurova

Ndoshta edhe sonte si gjithmonë
Më duhet të qaj
Nuk di cilën kohë
Të kaluarën ose të ardhmen
Por gjithsesi duhet ta përjetoj lindjen time
Në kokën e vjedhur të etërve

Asnjë njeri s'dukej në horizont
Kraçkëllimat e çrregulluara
Të çafkave
Më bënë t'i harroj
Të trokiturat e rigave të shiut
T'i harroj dhembjet që
çmendnin edhe gurin

NUK JAM NË GJENDJE TË GJYKOJ

Kjo turbullirë megjullash
Dhe mendjesh
Ndoshta po vjen koha e zhgënjimeve
Kujt t'i besojmë sivjet
Kur për çdo stinë
Po na mashtrojnë me nga një lëpizë

Një zhgënjim i vërtetë duket
Diku larg në horizont
Por prapëseprapë është zhgënjim
Mashtruesit matrapaz
Si hebrenjtë e moçëm
Po i fërkojnë duart e rrudhosura

Kjo kohë e gazetave
Trenave të ngarkuar me gënjeshtër
Po na përcjellë me qindra zhgënjime
Nuk jam në gjendje të gjykoj
Dorën e mashtruesit të cilën
Orë e çast
I gjej në xhepat e mia të grisura

DUKE QESHUR SIÇ DINTE VETËM AI

Dyert na i bënë shoshë
Diku te vrimat
Mbetën peng plumbat
E diku tjetër
Shpuan tej e përtej
Drurin e moçëm të bungut

I shpuan edhe gurët e kullës
E cila njëmijë dymijë vjet
U bëri ballë stuhive
Sot disi e ligështuan dhembjet
E bënë aq të ligë
Që të vajtojnë shtatë mëhallë

Im atë si gjithmonë krenar
Rrapi shtatlartë i cili kurrë s'përkulet
Shikonte atë breshëri të plumbtë
Shikonte dhe syri s'i bënte vër
Duke qeshur siç dinte vetëm ai
Shtiri në thumb ariun e Karpateve
Prishtinë, 18 janar 2019

Cikli i tretë
Ata dinin me pritë në dy mënyra

ATO STËRKALA TË MJEGULLAVE

Kur ngryset moti
Nën hijet e pemëve të egra
Dëgjoj muzikën e zambakëve
Atë muzikë
E cila ringjallë të vdekurin nga qivuri

Më pastaj bëj një shëtitje
Nëpër rrënjët e shelgjeve të pikëlluar
Por muzikën e luleve
Asnjëherë
Nuk e lë pas dore

Si fëmijë mësova nga im atë
Tregimin për rapsodin i cili vdiq
Pa kënduar asnjë këngë për dashurinë
Kurse në anën tjetër
Ishte fundosur në zjarrin e dashurisë

Andaj sa herë që më kujtohen zambakët
Ulem nën hijen kujtesës
Dhe i thërras shirat
Ato stërkala të mjegullave
Rigat e pandërprera që m'i ledhatojnë flokët

QIRIU I CILI KURRË NUK SHKYÇET

Mbi tryezë dy molla të pjekura
Një trëndafil
Dhe qiriu
I cili kurrë nuk di të shkyçet

Hëna lozonjare me xheloz
Të paparë i përcjell
Këto pamje surrealiste
Gjersa në kopsht dëgjoj muzika e luleve

Është çasti i fundit
T'i mbushim xhepat me dashuri
Ashtu siç i mbushnim në rini
Me xixëllonja ta ndriçojmë dhomën e gjumit

Tryeza me dy molla të pjekura
Qiriu i cili
Kurrë nuk di të shkyçet
Me kënaqësi dëgjojnë muzikën e luleve

MBASE KËTO JANË SHENJAT E PARA

Një hënë e mërrolur shikon
Tej dritareve syprinën
E cila fundoset ngadalë
Në ëndrrën
E pa ëndërruar të luleve

Dy zogj dhe një njeri
Janë ulur
Në stolin e ronitur të kujtesës
Dhe shikojnë me habi
Fundosjen e diellit në perëndim

Sërish një flutur e kaltër
U ulë te drurët e posa të çelur
Jashtë në kopsht
Shikoj me habi
Dy pasqyre të varura te pemët

Shiu vjeshtak
Ngadalë troket në dyert e gjetheve
Troket si rrallë herë
Mbase këto janë shenjat e para
Se sa është afër pragpranvera

KJO PASQYRE E TEJDUKSHME

Kjo pasqyrë e varur në mur
Dhe e verbët
Nuk sheh asgjë
As nuk e shohim brendësinë e saj
Në pamjen e parë të pluhurosur
Gjithçka duket e vdekur

Sa herë që e pastroj me lot
Hapësirën e paanë të kornizës
Një fantazmë
Me zgërdheshet në shpirtin e saj
Kjo pasqyre e tejdukshme
I fsheh hijet si përroi kujtesën

Imazhet e largëta
Duken prej xhamit të errësuar
Por kur ja prek shpirtin
Një gjëmë e trishtuar
Buron nga brendia e padukshme
Buron një histori sa e afërt
Po aq edhe e largët

MBASE U KËNDELLËM TEPËR VONË

Ne ishim njerëzit e një atdheu
Pa atdhe
Liria për ne ishte një nocion
I pakapshëm
Nga një trishtim sajonim ëndrra
Njëqind vjet duke kërkuar dritën

As me pamjen tonë fizike
Si dhe me ADN-në
Nuk u shëmbëllenim
Atyre ardhacakëve të egër
Që ishin njerëz gjak ngrirë
Me një lëkurë asnjane

Dikur vonë
Tepër vonë kuptuam rolin
Të cilin e luanim për mrekulli
U mësuam nga pemët
T'i shtrimë rrënjët deri në thellësitë
Me të thella të nëntokës

Kur pamë se dielli mbi kokën tonë
Shndrite secilin njeri
Që mund të ecte në dy këmbë
Mbase u këndellëm
Pas disa qindra viteve
Filluam t'i shembim barrierat e urrejtjes

NË MJEGULLIMIN E QIELLIT TIM

Në errësirën më të errët
Nuk më mungojnë
Askurrë xixëllonjat

Sa herë që i shtrij duart
Ty të kam pranë
Ylli im i largët

Kur lëshohet në tokë sterra
Xixëllonjat e dynjasë
Shndrisin gjithmonë udhën time

Në mjegullimin e qiellit të errësuar
Si një yll e si një diell
Gjithmonë bëjnë dritë në qiell

ATA DININ ME PRITË NË DY MËNYRA

Kërmijtë e verdhë dhe buburrecat
Paskan mbetur peng
I këtyre mureve të rrënuara
Asnjë shenjë tjetër
Nuk shoh në afërsi të kësaj kornize
Vetëm era
Fryn me sëmbim nëpër xhamat e thyera

Thonë se shumë ushtarë
Dhe gjeneral dezertorë
Ikën të turpëruar
Ikën ledheve të kësaj toke
Erdhën të bëhem mbretër
Por u larguan me bisht ndër këmbë
Si përmendoret e rrënuara të turpit

Nuk ishte aq mikpritëse
Kjo tokë gratçore
E etërve të mi dardanë
Ata dinin me pritë në dy mënyra
Me bukë e kripë e zemër
Por pritnin edhe me breshëri plumbash
Armikun e pabesë në thembër

I PËRKAS NJË RACE MË TË LASHTË NË BOTË

Pas shpine i lëmë kujtimet
Puthjet e para
Dhe ato të fundit
Nëpër shkurre dhe manaferra
Ndoshta do gjejmë vetveten
Diku mes hieroglifëve të shlyera

Nëpër varret e hebrenjve
Lexova dy epitafe
Vendosa dy lule
Pranë dy varreve të panjohura
Një shtërg i atdheut tim
M'i sjelli dy qirinj të bardhë

S'duroi varrtari pa më pyetur
Mos je vallë shqiptar
Duke qeshur iu përgjigja
Domosdo që jam
I përkas një race
Më të lashtë në botë

Vij nga ilirët dhe pellazgët e vjetër
Në kodet tona
Siç kemi mësuar
Duhet të respektohen të vdekurit
Andaj i vendosa dy lule të freskëta
Në këta dy varre të panjohur

DIKUSH KISHTE VEZË TË KUQE

Binte një shi i rreptë
S'mund t'i dalloja nuancat
E rigave që udhëtonin
Deri në theqafje
S'ishte stina e të reshurave
As ajo asnjëherë
Por shiu i çmendur nuk pushonte

Në pamundësi se si të veproj
I zbrazta xhepat
Duke i gjuajtur me guralecë
Mjegullat e plumbta
Që më bezdisnin
Me shirat e një stine të egër
E cila asnjëherë nuk ishte në atdheun tim

Për çudi edhe të tjerët
Si unë i zbrazën xhepat
Dikush kishte vezë të kuqe
E dikush tjetër
Me xhelozë në xhepa mbante një mollë
Duke thënë se do gjuaj Helenës së Trojës
Por me kënaqësi gjuante mjegullat e hirta

ASKUSH SONTE NUK TROKET

Prej dritares shikoj kopshtin e ngrysur
Jashtë dhomës sime bën acar
Po ashtu edhe sterra paska zbritur
Një mushkonjë e bezdisshme
Si kali i paçjerrë
Fluturon prej një skute në tjetrën

I shikoj dyert e mbyllura me dyllë
Të kyçura nga brenda
Sonte askush nuk troket
S'paska ardhur as korbi i Edgarit
Nëpër paradhomat e hejeve
Me hidhërim fshikullon acari i verdhë

Dyert nuk hapen për askënd
Përpos mendjes sime të shqetësuar
Askush nuk troket
Më duket se është bezdisur prej meje
Edhe vetmia
Janë lodhur njerëzit nuk m'i hapin dyert

KOHA PA TË ARDHMEN E SAJ

Me një dorë shtrëngon maskën
Kurse me tjetrën fytyrën
Një zog i zi
Çukit në xhamat e errëta të mendjes

Askush nuk lajmërohet
Nga brenda
Vetëm kërmijtë lërojnë me jargë
Muret e zeza të korridoreve

Shikoj një vazo të zbrazët
Asnjë lule nuk rritet në brendinë e saj
Përpos disa lloje krimbash
Përjetojnë katarzën e fundit

Një zog i zi dhe dora prej hejeve
Shkulin kujtimet e së kaluarës
Koha pa të ardhmen e saj
Bredhë rrugëve si zogjtë shurdhmemec

MË BLEJ NJË BRRUSHË TË DHËMBËVE

Kij kujdes e dashur
Në këtë vazo të drunjtë
I vendosa tri trëndafila të egra
Dhe protezat e dhëmbëve
Mos të më infektohet goja

I lashë edhe disa gjëra të imta
Nga përditshmëria ime
Mbasi t'i hekurosësh çorapet
Afroje taketuken
Se mbrëmë sërish fillova të pi duhan

Fillova se më egërsoi kjo politikë
Neve pleqve
S'na llogarisin në rendin e njerëzve
Nuk kemi se për çfarë të protestojmë
Përpos të kërkojmë t'i rregullojnë varret

Mos harro të lutem e dashur
Mos harro
Më blej një brushë të dhëmbëve
Sepse asaj të vjetrës
Ka kohë që i ka skaduar afati

NDRYSHOJNË KUR TË JU TEKET

Më duket se kot rri në verandë
Shikoj kah bien shirat
Bien si gjethet në vjeshtë
Qenka zverdhur sivjet dimri
Kjo kohë mospërfillëse
Si statuja qëndron mbi dy trëndafila

Në qytetin tim stinët
Çdo vit ndryshojnë shumë herët
Herë vjen dimri
E herë pranvera me zambakë të bardhë
Duke zbritur si mbretëresha
Mbi shkumën e Lumëbardhit

Ju thashë se stinët për çudi
Ndryshojnë kur të ju teket
Nuk pyesin për sëmundjet shiatike
Ani që neve të moshuarve
Nuk na pëlqejnë ndryshimet e moteve
Të rinjtë këpusin trëndafila për të dashurat

PARA SE TË PARAQITET AGULLIMA

Nga një dritare gjysmë e thyer
Që i përngjan gjysmëhënës
Çdo mëngjes shikoj
Lindjen e gjysmë diellit
Befasisht kuptoj se nuk qenka
Një lindje e rëndë siç pohojnë gratë

Ai lind tërë i buzëqeshur
Asnjëherë askush
Nuk ia ka dëgjuar vajin e trishtuar
Ose vigmën e hallakatur
Dielli gjithmonë lind nga shpirti i erës
Lind me një buzëqeshja foshnjaraqe

Dritarja ime gjysmë e thyer
Ajo gjysmë hëne
E cila kurrë nuk i ndali të qeshurat
Çdo mëngjes herët
Para se të paraqitet agullima
Ndjej përshëndetjen e qeshjes së saj diellore

MBASE NJËHERË E PËRGJITHMONË

Ishte dimri i acartë
Nga mëngët e përmendores
Pikonin hejet e kristalta
Një nënëloke e hoqi shaminë e bardhë
Nga flokët e saja të thinjura
Dhe ja mbuloi shpatullat përmendores

Në shenjë mirënjohjeje
Bronzi i rëndë deshi ta përshëndes
Kjo nënë krenare
S'lejojti të përulet përmendorja
Por në vend të saj
Ajo si bjeshka u përkul deri në tokë

Nënëlokja pa shami
Të cilën mbi shtatëdhjetë vjet
E barti me krenari mbi kokë
Sot e largoi
Mbase njëherë e përgjithmonë
Vendosi mbi shpatullat e përmendores

MUA MË RITI KËNGA DHE LAHUTA

Nuk më kujtohet e kaluara
Mbase asnjëherë nuk derdha lot
Kur u linda pa dëshirën time
Thonë se kisha nxjerrë një britmë
Sa që kishin rënë në dy gjunjë rrapet

Ju mund të mos më besoni
Por pyetni ata që kanë qenë të pranishëm
Vajin kurrë nuk e desha
As që durova
Të shoh sytë që lotojnë si te foshnjat

Mua më rriti kënga dhe lahuta
Gjithmonë i kam dalë përballë
Të ligave
Jo me lot por me guximin
E etërve të mi krenarë

NËPËR SYPRINËN E LËRUAR TË JETËS

Tani më nuk po më kujtohet
Se kur u verbua lumi
Para lufte
Ose pas kur vdisnin njerëzit nga uria
Por gjithsesi lumi u verbua

Atë çast ndjeva një sëmbim të thellë
Ndjeva se më dhemb shpirti
Por asnjëherë nuk arrita
Të preki me gishtat e mi
Plagën që me vite kullonte qelb

Lumi im i fëmijërisë ndjesë pastë
Vdiq para se të lindte përroi
Ishte një gurgullimë e paparë
Rrokullisje gurësh
Nëpër syprinën e lëruar të jetës

NGA FRYMËMARRJA E NJË PEME

Këtu nuk është fillimi
Kjo rrugë s'paska fund
Kur të mbërrimë te pema e jonë
Do kuptojmë prej gjetheve
Se ato që bien të fundit
Rrëfejnë një fillim të ri

Ja pra se si duket fundi
I cili nuk ekziston
Varri nuk është as fillimi
E as fundi im
Unë filloj aty ku ti e përfundon tregimin
Dhe pas meje vazhdon tjetri

Kjo lojë e natyrës gjithmonë ndryshon
Por asnjëherë
Nuk e humb bukurinë e saj
Njerëzit kureshtarë jetojnë
Nga frymëmarrja e një peme
E cila kurrë nuk i shkund gjethet

Prishtinë, 19 janar 2019

Adem Zaplluzha u lind më 1943 në Prizren, Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa Akademinë Pedagogjike në Prishtinë. Një kohë punoi si mësues nëpër fshatrat Studençan të Therandës (ish Suharekës) dhe Hoça e qytetit, afër Prizrenit. Ndërkohë punësohet si përkthyes në Korporatën Energjetike të Kosovës. Me shkrime filloi të merret kryesisht me poezi që nga mosha e fëmijërisë. Rugën letrare e nisi me vjershën e parë për fëmijë të cilën e botoi në revistën “Pionieri”, më 1957. Si i punësuar në Korporatën Energjetike të Kosovës bashkë me shokët e punës dhe pendës themeloi grupin letrar “Lulëkuqet e Kosovës”. Në Kuadër të punës së këtij grupi letrar qe botuar përmbledhja “Ngjyra e kohës”, në të cilën u përfshi një numër i konsideruar i poezive të tij. Krahas krijimeve të publikuara në revistat për fëmijë, botoi edhe një serë shkrimesh nëpër gazetat e kohës që dilnin në Prishtinë dhe Shkup. Është anëtar i Lidhjes së shkrimtarëve të Kosovës, prezent në disa antologji dhe në librin Kosova letrare të poeteshës Monica Mureshan. Është prezantuar në Leksikonin e Shkrimtarëve Shqiptarë 1501-1990, nga Hasan Hasani, në Leksikonin Shkrimtarët Shqiptarë për fëmijë 1872 - 1995 nga Odhise K. Grillo, si dhe në librin Portrete Shkrimtarësh nga Demir Behluli, Prishtinë, 2002 Në maj të vitit 2013 Klubi i Artistëve dhe i shkrimtarëve të Durrësit ia ndau çmimin e

karrierës për kontributin e dhënë në letrat shqipe.
Jeton dhe krijon në Prishtinë.

BOTIME TË AUTORIT

1. “Puthje”, poezi, “Rilindja”, Prishtinë, 1974.
2. “Ecjet e viteve të mëdha”, poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë 1995.
3. “Çamarrokët e Thepores”, poezi për fëmijë, “Shkëndija”, Prishtinë 1996.
4. “Muret”, poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë, 1997
5. “Morfologjia e dhembjes”, poezi, “Faik Konica”, Prishtinë, 2000
6. “Ai vjen nesër”, poezi, Qendra e Kulturës, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2007
7. “Letër nga mërgimi”, poezi, Klubi letrar “Fahri Fazliu” Kastriot, 2007
8. “Letër nga mërgimi 2 “ poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar , “Fahri Fazliu”, Kastriot 2007
9. “Udhëdarja”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar ;“Fahri Fazliu”, Kastriot , 2008
- 10 “Thirrje e gjakut”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu”Kastriot 2008
11. “Asgjë sikur molla”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2009.
12. “Vesa në lotin tim”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, 2009,

13. "Puthja e gozhduar", poezi, "Qendra e Kulturës", Klubi letrar, "Fahri Fazliu", Kastriot, 2009.
14. "Kashelasha në vargje", poezi për fëmijë," Qendra e kulturës, Kastriot, 2009.
15. "Pema e bekuar", E përkthyer, Rumani, 2010.
16. "Bajraktarët e vatanit", poezi satirike, Klubi letrar, "Fahri Fazliu" Kastriot, 2010.
17. "Hijet e ndryshkura", poezi,"Qendra e kulturës", Kastriot, 2010.
- 18."Stuhi në Kutulishte", poezi, "Qendra e kulturës", Kastriot, 2010.
19. "Posa ikte nata", poezi, "Qendra e kulturës ", Kastriot, 2010.
20. "Loja e myshqeve", poezi,"Qendra e kulturës", Kastriot, 2010.
21. "Lumëbardhi dhe gjëma", poezi,"Qendra e kulturës", Kastriot, 2010
22. "Metafora e heshtjes", poezi, "Qendra e kulturës", Kastriot, 2010
23. "Hyji në Prekaz", poezi,"Qendra e Kulturës", Kastriot, 2010.
24. "Sinorët e hinores", poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot 2010.
25. "Don Kishoti dhe Rosinanti", poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
- 26."Zjarri i dashurisë", poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
27. "Kur likenet vallëzojnë", poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2010
28. "Ditari në vargje", poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010

29. “Tingujt që nuk përfundojnë”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2010.
30. “Shtegu i mallit”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2010
31. ”Korniza e thyer”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2010
32. “Zgjimi i gjëmës”, Poezi, Shoqata e Shkrimtareve, Kastriot, 2010
33. “Vallja mistike”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
34. ”Merre kodin”, Poezi për fëmijë, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2011
35. “Letër atdheut” poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011
36. “Tejdukshmëria e shiut”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011
37. “ Përtej teje”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011
38. “Sa afër e sa larg”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2011
39. “Vallja e zanoreve”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011
40. “Ikja e eshtrave”, Poezi për të rritur, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011
41. ”Kalorësit e mjegullave”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
42. “Hingëllimat e shiut”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
43. “Kur pemët i ndërrojnë këmishët”. Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012

44. “Mirëmëngjesi Imzot”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
45. “Kafshimi i mikut”, Poezi satirike, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
46. “Atje tej maleve”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve , Kastriot, 2012
47. “Heshtja që del në shesh,” Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
48. “Portat e shpresës”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
49. “Në dhomën time gjysmë të errët”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
50. “Kinse Lojë Shahu”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
51. “ Për çdo dekadë nga një baladë “, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
52. “Fusha e mëllenjave”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
53. “E kujt është kjo vetmi”, Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
54. “Mos pyet për adresën e lumit”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
55. “ Stoli në parkun vjetër” Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
56. “Urori i stralltë”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
57. “Po të mos ishte fjala”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot,2012
58. “Thyerja e urave”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
59. “ Trokëllimat në gjumin e dallgëve”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012

60. “ Në flokët e dëborës”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
61. “Një grusht nostalgji”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
62. “ Kur filluan të flasin njerëzit”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
63. “Kur stinët kapërcejnë fshehurazi”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
64. “ Lisi në rrënjët e veta” , Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot 2012
65. “Eca ecëm dhe do ecim”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
66. “Fëmijët e erës”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot 2012
67. “ Çast në fund të stinës”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
68. “Si të flas me drurët”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
- 69, “ Më pëlqejnë mendimet e tua”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot , 2012
70. ”Andej dhe këndej kohës”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot , 2012
71. “Zëri i heshtjes”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
72. “Kush i lexoi letrat prej erës”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
73. “ Fluturimi i korbave në netët pa hënë”, prozë poetike, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
74. “Koha e ime dhe koha e jote”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot , 2012
- 75.” Diku te një baladë”, Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012

76. “ Sonte çdo gjë po i përngjan lotëve”,Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
- 77 “ Ky def prej hëne”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
- 78.“Pyesni zogjtë në ikje ”,Poezi , Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot 2013
- 79 “ Fërfërimë gjethesh”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
80. “Refrene yjesh”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
81. “Te delta e mjellmave”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
- 82.“Rinjohja”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
- 83.“Diku në fund të një fillimi”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
- 84.“Mëkati i hijes”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
- 85.“Një zog prej uji”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
- 86.”Asnjë fjalë nuk frymon”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014.
- 87.”Daullet e një nate”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
- 88.”Sytë e gurtë të erës”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
- 89.”Kur dehen perënditë”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
90. “Fjetëm njëqind shekuj” Prozë poetike, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014.

91. "Kraçkëllimat e natës", Poezi, Shoqata e shkrimtarëve "Fahri Fazliu", Kastriot, 2014
92. "Ndjekësit e enigmave", Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu", Kastriot, 2014
93. "Atdheu i paçmuar" Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu", Kastriot, 2014
94. "Psalm i harruar ", Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, "Fahri Fazliu" Kastriot 2014
95. "Për kë po bie moj kambanë", Poezi Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu", Kastriot, 2014
96. "Mbi flokët e ullukëve", Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu" Kastriot 2014
97. "Menatë vijnë lejlekë", Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu" Kastriot 2014
98. "Loti i gotës së dehur" , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu" Kastriot 2014
99. "Stina asnjane", Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu" Kastriot 2014
100. "Dëneste bashkë me erën" Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu" Kastriot 2014
101. "Druri i pikëlluar", Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, "Fahri Fazliu", Kastriot, 2014
102. "Një grusht dashuri", Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, "Fahri Fazliu", Kastriot, 2014
103. "Lëreni zërin tim", poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, "Fahri Fazliu", Kastriot, 2014
104. "Shi në qytetin tim", Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, "Fahri Fazliu", Kastriot, 2014
105. "Si trenat e verbër ", Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, "Fahri Fazliu", Kastriot, 2014
106. "Zjarri i malli tim ", Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, "Fahri Fazliu", Kastriot, 2014

107. “Kur teshtin era”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
108. “Mbi shpirtin e erës pagane”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
109. “Nëpër gjymtyrët e mjegullave”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
110. “Ajo nuk erdhi sonte” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
111. “Një hënë e zhveshur”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
112. “Nëpër plasaritjet e mureve”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
113. “Mes telave gjembor ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
114. “Të vizatosh një zog në mur”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
115. “Nuk flenë as kuajt e dehur” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
116. “Fluturojnë zogjtë e verbër ” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
117. “Një shi prej bryme” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
118. “Në prehrin e pemëve” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
119. “Zëri i largët i shiut ”, Poezi Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
120. “Yjet e ngrira të kujtesës ” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
121. “ Thirrmat e hijeve”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015

122. “Dritaret e verbëta ”, Poezi, Shtëpia Botuese”TREND”, Prishtinë, 2015
- 123 . “Përtej portave të mbyllura”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
124. “Malli i etjes” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
125. “Kur qajnë pemët ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
126. “Të dielave në qytetin tim ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
127. “Nëpër brigjet e kujtesës” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
128. “Rrugës qante një stërqok”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
129. “Kali im prej bore” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
130. “Përballë hijes së mollës ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND “, Prishtinë, 2016
131. “Jehu i zërave”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
132. “Në kujtesën e pemëve ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND “, Prishtinë, 2016
- 133.“Më mirë një gjysmë ëndrre ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND “, Prishtinë, 2016
- 134.“Një dry prej dylli ” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016.
- 135.“ Në anën tjetër të mendjes”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
- 136.“Sa shumë ethe pat dimri sivjet”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
137. “Enigmat e kashelashave ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016

138. “Nuk i them unë dot kësaj liri” , Poezi,
Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
139. “Fluturat prej letre ”, Poezi,
Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
140. “Fluturimi i gjinkallës”, Poezi, Shtëpia Botuese
“TREND”, Prishtinë, 2016
141. “Kumritë prej deltine”, Poezi, Shtëpia Botuese
“TREND”, Prishtinë. 2016
142. “Më pritni te baladat e gurit”, poezi, Shtëpia
Botuese “TRENDI”, Prishtinë, 2017.
143. “Trenat këtu gjithmonë vonohen”, Poezi,
Shtëpia Botuese “TRENDI”, Prishtinë. 2017
144. “Lulëzojnë gjethet e ullinjve”, poezi, Shtëpia
Botuese “TRENDI”, Prishtinë, 2017
145. “Teatri antik i kujtesës”, Poezi, Shtëpia Botuese
“TRENDI”, Prishtinë. 2017
146. “Portreti i lirisë”, poezi, Shtëpia Botuese
TRENDI”, Prishtinë, 2017
147. “Një stinë delikate”, poezi,
Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2017
148. “Te ullishtat e vjetra ”, Poezi, Shtëpia Botuese
“TRENDI”, Prishtinë. 2017
149. “Ishim të lumtur si gjinkallat”,
poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2017
150. “Pikëllimet e rrënjëve”, Poezi, Shtëpia Botuese
“TRENDI”, Prishtinë. 2017
151. “Telat e shirave ” poezi, Shtëpia Botuese
TRENDI”, Prishtinë, 2017
152. “Një stuhi prej bryme”, Poezi, Shtëpia Botuese
“TRENDI”, Prishtinë. 2018

- 153.“Sonte s’ka dashuri ” poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2018
- 154.“i shëmbëllente pluhurit kozmik”, Poezi, Shtëpia Botuese “TRENDI”, Prishtinë. 2018
- 155.“Llamburite atdheu i plagosur” poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2018
- 156.“Gurët e pjekur shtatë herë” poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2018
157. “Kur të dalë nga kjo stinë” poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2018
- 158.“Ishin thyer te gjitha urat ” poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2018
- 159.“Gjethi i këputur në vjeshtë ” poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2018
- 160.“Ti mundesh nëse do” poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2018
- 161.“Pëllumbat prej rrufeve”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2018
162. “Diku në zbrazëtinë e ndërgjegjes”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2018
- 163.“Retë e dendura të kujtesës ”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2018
-
- 164.“ Pak diell e shumë acar”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019
- 165.“Kur kyçen yjet e harresës ”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019
- 166.“Nga pragjet e shtëpive”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019
- 167.“Fluturat e djegura ”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019

168. “Përtej asaj peme”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019
169. “ Kuajt e mjegullave”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019
170. “Po të ishte ndryshe ”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019
171. “Kur kthehen zogjtë e shiut ”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019
172. “Mes gishtave të hijes”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019
173. “kush i theu xhamat e shiut”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019
174. “Poemat e dhembjekrenarisë ”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019
175. “Marsi i çmendur në dy kohës”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019
176. “ Kur dënesin varret”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2019
177. “ Mos më uroni udhë të mbarë”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë
178. “Nuk mjafton të kesh vetëm emër ”, poezi, Shtëpia Botuese TRENDI”, Prishtinë, 2020

PËRMBAJTJA

Cikli i parë

Sa bukur qante ai burrë gjigant.....17

Rroftë demokracia.....	19
Kam të ftohtë nëpër damarë.....	20
Sa bukur qante ai burrë gjigant.....	22
Lëkurën e qiellit tim.....	23
Ky det i çmendur.....	24
Duart e dërmuara.....	25
Rëra nën hijen e mykur.....	26
Brekëçjerrët bredhin sokakëve.....	27
Përtypnin atë udhë të turpit.....	28
Në ingranazhet e padrejtësisë.....	29
Kështu që secili prej nesh.....	30
Ja pra se si duket kjo demokraci.....	31
Në çdo kohë na e ngrinë gjakun në shpirt.....	32
Çfarë të bëjë unë i mjeri.....	33
Dikush bie thumbit.....	34
Ne të mjerët kërkojmë më mirë.....	35
Afishet e ngjitura.....	36
Ishte koha e nxjerrjes së arkivoleve.....	37
U prinin deri në vdekje.....	38
I vramë edhe zogjtë.....	39
Të mbjellim filiza të reja.....	40
Mbase ishim bijtë e qiellit.....	41
Kafsha e egër e njerëzimit.....	42

Cikli i dytë

Sa bukur qante ai burrë gjigant.....43

Ishte një njeri i thinjur.....	45
Sa bukur qante ai burrë gjigant.....	46
Furtuna frynte si ne çmendur.....	47
Shikonte në mënyrë habitore.....	48
Nuk mjafton të kesh vetëm emër.....	49
Takova hijen time.....	50
Kur këndon nëpër ullukët e çatave.....	51
Nëpër rrënjët e zambakëve.....	52
Me shijen e njelmësisë.....	53
Mbase pikonte gjaku i gjelave.....	54
Kishin ikur edhe çafkat.....	55
Kur jemi në ndonjë gjendje apatike.....	56
Dikush i çrrënjosi edhe kishat.....	57
Për udhëtimin e fundit.....	58
Nën strehët e harruara.....	60
Dua të më plotësohen dëshirat.....	61
Përpos emrit.....	62
Garonin hardhucat e pjekur.....	64
Unë kisha tjetër atdhe.....	65
Nga një apo dy gota.....	66
Mbeti pa frymëmarrje.....	67
Në heshtje po zbrazej fshati i vdekur.....	68
Që kishin mbetur gjallë.....	69
Në këtë shtjellim të shurdhtë.....	70
Ndoshta njëqind vjet.....	71
Të trokiturat e rigave të shiut.....	72
Nuk jam në gjendje të gjykoj.....	74
Duke qeshur siç dinte vetëm ai.....	75

Cikli i tretë

Ata dinin me pritë në dy mënyra.....	77
---	-----------

Ato stërkala të mjegullave.....	79
Qiriu i cili kurrë nuk shkyçet.....	80
Mbase ato janë shenjat e para.....	81
Kjo pasqyrë e tejdukshme.....	82
Mbase u këndellëm tepër vonë.....	83
Në mjegullimin e qiellit tim.....	85
Ata dinin me pritë në dy mënyra.....	86
I përkas një race më të lashtë në botë.....	87
Dikush kishte vezë të kuqe.....	89
Askush sonte nuk troket.....	90
Koha pa të ardhmen e saj.....	91
Më blej një brushë të dhëmbëve.....	92
Ndryshojnë kur të ju teket.....	93
Para se të paraqitet agullima.....	94
Mbase njëherë e përgjithmonë.....	95
Mua më rriti kënga dhe lahuta.....	96
Nëpër syprinën e lëruar të jetës.....	97
Nga frymëmarrja e një peme.....	98

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

821.18-1

Zaplluzha, Adem

Nuk mjafton të kesh vetëm emër / Adem Zaplluzha. -
Prishtinë : Trendi, 2020. - 115 f. ; 21 cm.

ISBN 978-9951-757-51-5